

Bazuar në Urdhërin Nr.5376 Prot, datë 31/08/2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Sigurimeve Shoqërore “Për hapjen e procedurës së rekrutimit të personelit nëpërmjet konkurimit të hapur”, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, bën shpalljen e vendit të lirë të punës për pozicionin:

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës

Përgjegjës i ALSSH Krujë

Kandidatët duhet të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Profesional” ose të barazvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë, në Shkenca Ekonomike, Juridike, Shkenca Sociale. Të kenë të paktën 3 vjet eksperiencë në fushën e administratës publike dhe/ose në një nivel të mesëm menaxhimi në institucione private.

Të kenë eksperiencë pune mbi 2 vjet në nivel specialisti për punonjësit brenda administratës së sigurimeve shoqërore,

KËRKESAT QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI

- Te jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtjeje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga sistemi i sigurimeve shoqërore, shërbimi civil ose administrata publike që nuk është shënuar sipas dispozitave ligjore në fuqi e ISSH në datën **23.03.2021, ora 10.**

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM & INTERVISTA

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

Njohuritë në fushën e Sigurimeve Shoqërore (statusi i ISSH, Ligji Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”;

Njohuri të Rregulloreve të përfitimeve, kontributeve, financiare, personelit dhe për sistemin e informacionit të ISSH;

Njohuri të Ligjit Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat"

Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë,
Ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008 Për mbrojtjen e të dhënave personale",
Ligji Nr .9367, datë 7.4.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në ushtrimin e Funksioneve Publike,
Ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”;

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Në vlerësimin e kandidatëve përfshihen: a) vlerësimi i jetëshkrimit të kandidatëve: që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën;
b) vlerësimi me shkrim: që konsiston në vlerësimin e njohurive për legjislacionin e zbatueshëm për sigurimet shoqërore, organizimin administrativ në sistemin e sigurimeve shoqërore, për nivelin e njohurive akademike dhe profesionale, bazuar në kriteret e përcaktuara;
c) intervista me gojë ku zhvillohet intervistimi i kandidatëve, i cili synon të evidentojë formimin e përgjithshëm, si dhe vizionin e tyre mbi veprimtarinë e sigurimeve shoqërore dhe për pozicionin që konkuron.

Totali i pikëve të vlerësimin të kandidatëve është 100, të cilat ndahen përkatësisht:

- a) për vlerësimin e jetëshkrimit (CV) të kandidatëve, deri në 20 pikë;
- b) për intervistën me gojë, deri në 40 pikë;
- c) për vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë.

Kandidatët konkurues kualifikohen nëse në total kane fituar mbi 70 pikë nga 100 pikë të mundëshme, gjatë fazës së vlerësimin.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat në zyrën e protokollit të ISSH-së, si më poshtë:

- Një kërkesë për konkurim për pozicionin e punës për të cilin janë të interesuar;
- Një kopje të jetëshkrimit (CV);
- Fotokopje e diplomës dhe listës së notave (e noterizuar);
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- Raport i aftësisë për punë;
- Fotokopje të librezës së punës;
- Çertifikata ose dëshmi të kualifikimeve, trajnimeve të ndryshme;
- Fotokopje të kartës së identitetit;

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumentave duhet të bëhet brenda datës 14/09/2021 pranë zyrës së prokoll / sekretarisë në ISSH.

Nuk pranohen në konkurim kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara më lartë.

Testimi me shkrim do të zhvillohet në ambjentet e ISSH në datën **17.09.2021, ora 10.**

Intervista me gojë do të zhvillohet në ambjentet e ISSH në datën **19.09.2021, ora 10.**